REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.306/1 Prot. Maliq, më 23.01.2026

NJOFTIM

LËNDA: Mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Maliq

DREJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK MALIQ
KRYETARIT TË BASHKISË MALIQ

Të nderuar,

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* datë 17.12.2015, i ndryshuar, neni 53, *"Funksionimi i këshillit bashkiak"*, pika 2, pika 4 dhe 5, neni 56 *"Kryetari i këshillit bashkiak"* pika 2 gërma "a", dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, *"Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Bashkisë Maliq"* ju njoftojmë se mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Maliq do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të këshillit ditën e premte**, më datë 30.01.2026, ora 10:00** me këtë,

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 24.12.2025.
4. P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin dhjetor 2025";
5.P-V"Për miratimin e kritereve, porcedurave, dokumentacionit, për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit, për vitin 2026'';
6. P-V "Për miratimin e kritereve, porcedurave, dokumentacionit, për familjet në nevojë, që do të trjatohen në Ndihmë Ekonomike nga fondi i buxhetit vendor, për vitin 2026'';
7.P-V Për miratimin e bursave të nxënsve ekselente që ndjekin studimet në shkollat e mesme të bashkisë Maliq për vitin shkollor 2025-2026";
8.P-V "Për miratimi përfituesve nga programi subvencioni i qirasë për strehim";
9.P-V "Për përjashtimin nga pagesa e qirasë sociale për familjet e strehuara në banesën sociale pranë "Ish Labratorit";
10.P-V "Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për periudhën 2027-2029";
11.P-V "Për dhënien në përdorim të sipërfaqes prej 20 m^2 në ngastrën nr.39c të Ekonomisë Pyjore Moglicë, fshati Gurëshqipe, Nj.A Moglicë, Bashkia Maliq, me qëllim ngritjen e një antene telefonike nga kompania Vodafone Albania sh.a";
12.P-V "Për ngritjen e Komisionit të përkohshëm mbi verifikimin e dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet e muajit Nëntor 2025 në rrugën e fshatrave Velçan, Selcë, Mesmal Nj.A Gorë" Bashkia Maliq";
13.Fillimin e procedurave për zgjedhjet në fshatrat e mbetura pa u zhvilluar zgjedhjet për Kryetar Fshati dhe në fshatin Rov ku është krijuar vakancë.

14.Diskutime të tjera.

- **Të tjera pika informuese:**

Raport lidhur me vendimarrjen dhe performancën e Këshillit Bashkiak Maliq për vitin 2025.

Informacion kërkuar nga Këshilli lidhur me procesin e dhënies së Titujve të Nderit.

Shënim: Mbledhjet e Komisioneve të Këshillit do të mbahen ditën e mërkurë me datë 28.01.2026 nga ora 10:00-13:00 si më poshtë:

Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut. Pikat 4, 5, 6 e rendit të ditës:
z.Faslli Zholli, znj.Gentiana Drabo, z.Armando Dautllari, z.Plator Çollaku, znj.Marjeta Xhelollari

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare. Pikat 10 dhe 11 të rendit të ditës:
z.Petrit Kupe, znj.Pranvera Begolli, znj.Marianthi Avrami, znj.Eglantina Balli, z.Andonaq Risto.

Komisioni i Arsimit, Sporteve dhe Çlodhjes. Pika 7 e rendit të ditës:
znj.Neresida Shindo, znj.Gentiana Drabo, znj.Daniela Ibrahim, z.Lulëzim Hoxhaj, z.Faslli Zholi.

Komisioni i Zhvillimit Hapësinor, Infrastrukturës dhe Strehimit. Pikat 8 dhe 9 të rendit të ditës: z.Idlir Limllari, z.Selami Muço, znj.Pranvera Begolli, z.Almir Elezi, z.Faslli Zholi.

Komisioni Mandateve, Rregulloreve, Çështjeve Juridike, Qeverisjes së Mirë, Administratës, Zgjedhjeve, Strukturave Komunitare. Pikat 12 dhe 13 të rendit të ditës:
znj.Pranvera Begolli, z..Petrit Kupe, znj.Kristina Malelli, znj.Elganita Balli, z.Yllson Ibrahimllari

Ju faleminderit!

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ